



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic

Prosecution

Autoriteti Kompetent / Kryeprokurori

AD.nr.15/2024

Datë: 06.11.2024

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me pretendimet për shkelje disiplinore të parashtruara nga ana e palës P.D., përmes kërkesës për njoftim të pranuar më datë 23.10.2024, e të cilat pretendime janë trajtuar nga aspekti disiplinor, kundër M.K., Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 06.11.2024 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet ankesa disiplinore kundër M.K., Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, pasi që duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 dhe paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057), veprimet e prokurorit nuk paraqesin shkelje disiplinore.

Arsyetim

Me datë 23.10.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, ka pranuar parashtresën (kërkesë për njoftim) të palës P.D., ku në mes tjerash, në parashtresën e tij me shkrim krahas kërkesës për informim, ka theksuar edhe se prokurori M.K., i cili ka qenë prokuror kujdestar në trajtim të rastit ku si palë e dëmtuar ka qenë P.D., me ç'rast prokurori M.K. me mosnivicimin e rastit penal është përfshirë në shkelje disiplinore.

Në parashtresën e tij, pala ankuese potencon se prokurori ka vepruar në bazë “të treguarve” të policëve, duke abuzuar me pozitën e tij ashtu që sipas palës ankuese, prokurori M.K. me mosveprimet e tij ka rënë ndesh me Ligjin për Prokurorin e Shtetit, Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë si dhe Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, neni 6, par.1 nënpar.1.2 dhe 1.3, dhe paragrafi 2, nënpar.2.1 të Ligjit Nr.06/L-057.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore ndaj Prokurorit M.K.

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

- Me datë 23.10.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar ankesën disiplinore me numër AD.nr.15/2024.
- Me datë 24.10.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimin dhe regjistrimin e ankesës.

Të gjeturat e Autoritetit Kompetent:

Më datë 15.03.2024, pranë Stacionit Policor Jugu në Prishtinë ishte paraqitur pala ankuese P.D. i cili kishte raportuar se më datë 15.03.2024, sa ishte duke drejtuar automjetin e tij në Rr.“Andrea Aleks” në Prishtinë, pak metra para se të hyjë në parkingun nëntokësor, një person i cili kishte qenë duke drejtuar automjetin, pasi kishte kërkuar që të ndalet pala ankuese, i njëjti pastaj kishte dalë nga vetura e tij dhe i ishte afruar veturës së ankuesit duke ia hapur derën e veturës me vrull dhe i ishte drejtuar me fjalët “veç jam me qit çikë të vogël në kerr se dhëmbët ti thej e mos mu shit mangup”, me ç’rast pala ankuese pretendon se nga ky rast kishte pësuar shqetësime shëndetësore, ku pas deklaratës së dhënë në polici kishte marrë tretman mjekësor.

Zyrtarët policor, me të paraqitur rastin pala ankuese, kanë kontaktuar prokurorin M.K., i cili gjatë kohës kur ka ndodhur rasti ka qenë prokuror kujdestar në Departamentin e Përgjithshëm, ku i njëjti ka udhëzuar që fillimisht të iniciohet shënim zyrtar dedikuar njësisë së sektorëve për veprime të mëtutjeshme. Pas udhëzimit të prokurorit, zyrtarët policor kanë tentuar që nga të dhënat e siguruara nga pala ankuese të bëhet identifikimi i personit të dyshuar, mirëpo kanë rezultuar të pasakta në bazë të përshkrimit të ankuesit, në ndërkohë nga policia është identifikuar i dyshuari B.S., i cili është ftuar në stacion për intervistim, e pastaj është kontaktuar prokurori M.K. më datë 23.09.2024, ku i njëjti ka udhëzuar që rasti të iniciohet Kanosje, pasi që edhe pala ankuese ka ofruar disa fakte shtesë në lidhje me rastin. Më datë 15.10.2024, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka pranuar kallëzimin penal nga Stacioni Policor Jugu në Prishtinë, me numër të rastit, kundër të dyshuarit B.S., me dyshim se i njëjti ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181 i KPRK-së.

Duke analizuar rastin, po ashtu rrjedhën e veprimeve të ndërmarra nga Prokurori M.K., Autoriteti Kompetent vlerëson se veprimet e tij nuk përbëjnë shkelje disiplinore të cilat janë të parapara në mënyrë shprehimore me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit

- Marrja e raportit me shkrim nga ana e prokurorit M.K. lidhur me pretendimet ankimore.
- Shqyrtimi i kallëzimit penal ... si dhe shkresave penale të lëndës së evidentuar në prokurori nën shenjën PP.II....

Deklarimet e palës ankuese

Me datë 23.10.2024, pala ankuese P.D., ka dorëzuar në Prokurorinë Themelore në Prishtinë parashtresën e titulluar “Kërkesë për njoftim”, të cilën parashtresë e ka drejtuar te Kryeprokurori i kësaj prokurorie, e të cilën parashtresë ne si Autoritet Kompetent e kemi trajtuar nga aspekti disiplinor. Përmes parashtresës së tij, pala P.D. pretendon se me datë 15.03.2024, pak metra para se të hynte në parkingun nëntokësor, një person i panjohur për të, e që i njëjti ishte duke e drejtuar automjetin e tipit me targa ..., pasi që kishte kërkuar që të ndalet, kishte dalë nga makina e tij dhe i kishte hapur me vrull derën e parme të djathtë të automjetit që e drejtonte pala ankuese dhe e kishte kërcënuar rëndë dhe drejtpërdrejtë palën ankuese. I njëjti në parashtresën e tij po ashtu thekson se, më datë 07.05.2024 ka prezantuar në zyrën e prokurorit M.K. ku sipas bisedës që kanë pasur, të nesërmen me datë 08.05.2024 ia kam dërguar përmes Njoftimit edhe një USB, nga ku do të shihte videon, provat tjera dhe raportet mjekësore, mbi bazën e të cilave do kishte një fotografi më të qartë se për çka bëhet fjalë. Më datë 05.09.2024, pala ankuese i është drejtuar prokurorit në fjalë me kërkesë për njoftim, për çka me datë 16.09.2024 përmes postës elektronike (e-mail) ka pranuar njoftimin, ku prokurori në fjalë mbështetet tërësisht në hetimin e policit dhe nuk merr fare parasysh asnjë nga provat materiale, me çka sipas palës ankuese, krijon përshtypje se Prokuroria e Shtetit vepron sipas të treguarave të policëve. Po ashtu në këtë parashtresë theksohet ndër të tjera se, veprimet (mosveprimet) e prokurorit M.K. janë jo vetëm në kundërshtim të plotë me Ligjin nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, por janë edhe në kundërshtim të plotë me Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë, që përbëjnë edhe bazë për përgjegjësi disiplinore (në bazë të nenit 6 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.3, par. 2 nën par. 2.1 nga Ligji nr. 06/L-057), me çka sipas palës ankuese, prokurori në fjalë abuzon edhe me pozitën e prokurorit të shtetit, pra e keqpërdor besimin e dhënë si gardian i moralit të përgjithshëm shoqëror (në dëm të të dëmtuarit).

Deklarimet e Prokurorit M.K.. në raportin e tij të dt.28.10.2024

Prokurori M.K., në raportin e tij të dërguar përmes postës elektronike me datë 28.10.2024, ndër të tjera ka deklaruar se:

“Bëhet fjalë për periudhën e kujdestarisë së muajit Mars të këtij viti (2024), më saktësisht data 15.03.2024, ku është trajtuar rasti i Kanosjes, ku palë e dëmtuar është raportuar se është P.D. i cili është paraqitur në Stacionin Policor Jugu në Prishtinë, me pretendimin se është kanosur. Nga raportimi i rastit nga Zyrtari Hetues Policor V.L. kemi vendosur që Rasti penal policor të mbyllet me raport të Policit në kuadër të Stacionit Policor Jugu në Prishtinë, pasi kemi vlerësuar se nuk kemi dyshim të plotë të arsyeshëm se në rastin konkret është kryer vepra penale e kanosjes, duke pasur parasysh dy dëshmi antagoniste njëra me tjetrën të palëve, përkatësisht dëshmisë së të dëmtuarit dhe mbrojtjes së të pandehurit, jemi udhëhequr sipas parimit “in dubio pro reo” në favor të pandehurit, pasi nga ky i fundit ka mohuar në tërësi kryerjen e veprës penale, ndërsa në anën tjetër i dëmtuari ka këmbëngulur se ishte kanosur nga i dyshuari .

Rasti policor në Stacionin e Jugut është evidentuar, dhe nga raportimi i zyrtarit hetues policor V.L. më datën 15.03.2024 ku pala ankuese P.D., ka deklaruar para Stacionit të lartcekur policor “me datë 15.03.2024 rreth orës 22:40 derisa ka qene me veturën e tij në rrugën “Andrea Aleks” e cila gjendet mbrapa marketit “Maxi 24h”, në lëvizje për tu kyçur tek rrethi dhe një veturë tjetër e cila vinte përballë kishte ndaluar pasi që aty kishte pasur vetura të ndaluar anash dhe nuk mund të kalonin dy vetura në të njëjtën kohë andaj ky për një moment ishte ndaluar për ti dhënë përparësi dhe pasi që kishte ardhur vetura karshi kishte ndaluar dhe kanë shkëmbyer disa fjale “ pse s’po nisesh të blindova me drita , a e pe që t’dhash përparësi” dhe kishte vazhduar dhe prapë pas disa metrave ishte ndaluar, derisa personi del nga vetura tjetër dhe shkon i’a hapë derën dhe i thotë “veç

jom me qit qikë t'vogël se dhëmbët ti thej” . Vetura tjetër ka qenë ... me targa .. ose ... për të cilat nuk ka qenë i sigurtë. Në ndërkohë kemi gjetur personin i cili ka qenë duke e vozitur veturën në fjalë, targat kanë qenë, me shofer B.S. të cilin e kemi ftuar në stacion për intervistim, i cili ka deklaruar se po ka qenë duke drejtuar automjetin në fjalë dhe ka mohuar t'i ketë thënë fjalët e përmendura vetëm kanë diskutuar se “pse nuk pi grah veturës a pe sheh që e bllokove rrugën, a pe sheh që nuk po mundemi të kalojmë”, i njëjti po ashtu ka shtuar se gjatë mosmarrëveshjes që kishin pasur pala ankuese kishte bërë me gjeste duke i ngritur duart lartë.

Ndërkohë, pas pranimit të parashtrësave të bashkangjitura me dokumentacion mjekësor nga pala e dëmtuar P.D. (për të cilat dhe ju jeni në dijeni), pasi i kemi analizuar pretendimet e të njëjtit, të cilat i kemi vlerësuar si pretendime serioze, pasi nga theksimet e të dëmtuarit në parashtrësa, lë të nënkuptohet se në mbrëmjen kritike me datë 15.03.2024, me të vërtetë ka mundur të ndodhë që i dëmtuari P.D. të jete kanosur nga i dyshuari B.S. dhe që ekziston dyshimi se nga ky i fundit të jetë kryer vepra penale e Kanosjes, me datë 23.09.2024 pasi kemi analizuar dhe një herë të gjitha dëshmitë kemi vlerësuar se është e nevojshme të iniciohet rasti penal në mënyrë që nga Stacioni përkatës policor të grumbullohen edhe dëshmi të tjera shtesë nëse ka, me qëllim të sqarimit të të gjitha rrethanave përkatësisht vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike dhe me këtë rast kemi udhëzuar iniciimin e rastit penal për veprën penale Kanosja nga neni 181 të KPRK-së, ndërsa rasti penal policor mban numrin ... dhe nga Njësia e Hetimeve të Stacionit policor Jugu në Prishtinë janë duke u marrë veprime të mëtejshme deri në procedimin pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë.”

KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të palës ankuese P.D., pas shqyrtimit të raportit të prokurorit ndaj të cilit është iniciuar ky rast disiplinor, pas shqyrtimit të lëndës penale të evidentuar nën numrin PP/IL.nr..., kemi ardhur në konkludimin se veprimet e prokurorit M.K., lidhur me vlerësimin e tij si prokuror kujdestar të rastit të kujdestarisë i cili ka ndodhur më datë 15.03.2024, kanë qenë në kuadër të autorizimeve të tij ligjore dhe kushtetuese. Ligji nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, ka përcaktuar parimet themelore mbi të cilat funksionon Prokurori i Shtetit, respektivisht në nenin 4, paragrafi 1 përcaktohet se “Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme”, si dhe në nenin 4, paragrafi 2 të po këtij ligji përcaktohet se “Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat, pa asnjë diskriminim, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, legjislacionin në fuqi dhe konventa ndërkombëtare”.

Ndërkaq, në nenin 8, paragrafi 1 janë përcaktuar kompetencat dhe përgjegjësitë e prokurorëve, ku në nënparagrafin 1.7 të nenit 8 par.1 të këtij ligji theksohet se “1. Kompetencat dhe përgjegjësitë e prokurorëve përfshijnë: 1.7 marrjen e vendimeve mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penal”, andaj në këtë drejtim, Autoriteti Kompetent vlerëson se Prokurori M.K. ka vepruar në kuadër të kompetencave të tij me rastin e marrjes së vendimeve lidhur me këtë çështje, kjo për faktin se është në diskrecionin e prokurorit të shtetit, që varësisht nga rrethanat dhe specifikat e çdo rasti, të vendosë nëse duhet iniciohet rasti penal apo jo.

Duke u bazuar nga të dhënat e rastit konkret, vihet në përfundim se në kohën kur është pretenduar të jetë kryer vepra penale e kanosjes ndaj palës së dëmtuar P.D., specifikisht me datë 15.03.2024, kur edhe prokurori M.K. ka qenë prokuror kujdestar, e vetmja provë që inkriminonte kryerjen e

veprës ishte deklarata e të dëmtuarit, e cila nuk ishte e mjaftueshme që ta bindnin prokurorin kujdestar se në rastin konkret është kryer vepra penale. Kjo sepse me provat që ishin deri në atë kohë, pra deklaratat e dy palëve, të cilat ishin kontradiktore me njëra tjetër, ku i dëmtuari pretendon që është kanosur, kurse i dyshuari e mohon ta ketë kanosur, andaj në një situatë të tillë tek prokurori kujdestar nuk ka arritur që të krijohet dyshimi se në këtë çështje kemi të bëjmë me vepër penale, për çka edhe prokurori duke vepruar në pajtim me nenin 3 par. 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, ku specifikisht thuhet se *“Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*, duke i interpretuar mëdyshjet që i kishte në rastin konkret në favor të të dyshuarit, ka vendosur në atë mënyrë, duke mos iniciuar rast penal.

Prokurori i Shtetit M.K., me të pranuar më pas parashtresën e palës së dëmtuar P.D., ku të bashkangjitur kishte edhe dokumentacionin mjekësor, me ç’rast edhe i ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës, ka ardhur në përfundim se ekziston dyshimi se në rastin konkret mund të jetë kryer vepra penale e kanosjes ndaj palës së dëmtuar P.D., andaj me datë 23.09.2024 pas analizimit të deklaratave të të përfshirëve dhe dokumentacionit mjekësor të prezantuar nga pala e dëmtuar, prokurori M.K. ka udhëzuar policinë që të iniciohet rast penal, për veprën penale Kanosja nga neni 181 të KPRK-së, i cili rast policor mban numrin ..., ndërkaq sikur se edhe është theksuar më lartë, me datë 05.10.2024 nga ana e Drejtorisë Rajonale të Policisë – Stacioni Policor “Jugu” Prishtinë është dorëzuar kallëzimi penal kundër të dyshuarit B.S., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 të KPRK-së.

Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë obligon prokurorët që ndër të tjera të marrin parasysh edhe rrethanat që janë në favor të të pandehurit, në respektim të konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, gjithmonë në zbatim të standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare, e që në rastin konkret konsiderojmë se Prokurori M.K. në ndërmarrjen e veprimeve lidhur me rastin konkret, ka qenë në respektim të plotë të rregullativës ligjore vendore dhe asaj ndërkombëtare si dhe akteve të tjera nënligjore mbi të cilat funksionon Institucioni i Prokurorit të Shtetit.

Pala ankuese ndër të tjera ka pretenduar se prokurori M.K. ka rënë ndesh me nenin 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3, respektivisht pretendimet për shkelje të ligjit dhe shkelje të detyrave zyrtare si prokuror, neve si Autoritet Kompetent i kemi shqyrtuar edhe këto pretendime mirëpo nuk kemi evidentuar ndonjë shkelje të ligjit apo shkelje të detyrave zyrtare nga ana e prokurorit M.K. sa i përket rastin konkret. Ligji nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit i ka dhënë diskrecion të plotë prokurorëve lidhur me marrjen e vendimeve mbi iniciimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale, në kuptim të nenit 8 par. 1 nën par. 1.7 të Ligjit nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit. Për më tepër, Ligji Nr. 08/L-167 Për Prokurorin e Shtetit, neni 39, paragrafi 1 ka ofruar mbrojtje ligjore për këtë kategori, ashtu që *“Prokurorët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni për veprimet e ndërmarra, vendimet e marra, apo mendimet e shprehura që janë brenda fushëveprimit të përgjegjësisë të tyre”*. Në rastin konkret, prokurori M.K. ka vepruar në kuadër të autorizimeve të tij ligjore dhe kushtetuese, në respektim të akteve ligjore vendore dhe instrumenteve ndërkombëtare.

Duke u bazuar nga të gjeturat e theksuara si më lartë, në cilësinë e Autoritetit Kompetent, vlerësojmë se Prokurori M.K., nuk është përfshirë në veprime të cilat do të binin ndesh me

dispozitat e nenit 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057).

Nga krejt çka u konstatuar më lartë, kemi gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet e deklaruara në parashtresën e dorëzuar nga pala P.D., e cila është trajtuar në aspektin disiplinor, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar se veprimet e prokurorit paraqesin shkelje disiplinore në bazë të nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 dhe paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji Nr.06/L-057).

Në kuptim të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ankesën disiplinore e **REFUZOJMË SI TË PABAZUAR**.

Me sa u cek më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

AUTORITETI KOMPETENT - KRYEPROKURORI



Vendimi i dërgohet:

- **Këshillit Prokurorial të Kosovës**
- **Arkivës**